



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM
DEPARTMENT OF PROTECTION AND RESCUE – DIREKTORAT ZA ZASTITU I SPAS



Raporti 6 mujor Janar-Qershor 2026

HYRJE

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka vazhduar realizimin e aktiviteteve dhe detyrave sipas Planit të Punës së Drejtorisë, me fokus të veçantë në forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e emergjencave, rritjen e sigurisë së qytetarëve dhe përmirësimin e gatishmërisë operationale të Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë ndërmarrë një sërë aktiviteteve dhe veprimesh konkrete në drejtim të menaxhimit të situatave emergjente, koordinimit institucional dhe përmirësimit të kushteve të punës për personelin e zjarrfikësve.

Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet lokale dhe qendrore, si dhe me Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, është synuar rritja e efikasitetit në reagimin ndaj rasteve emergjente dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është punuar në avancimin e projekteve infrastrukturore dhe në përmirësimin e pajisjeve dhe mjeteve të punës për Njësinë e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe operationale.

Angazhimi i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim mbetet i vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët dhe në ngritjen e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat tjera në territorin e Komunës së Gjilanit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim realizon aktivitete të ndryshme dhe përfshirë organizimin dhe pjesëmarrjen në punëtori të ndryshme të organizuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare siç janë :Stacioni Policor në Gjilan (Drejtoria Rajonale të Policisë në Gjilan,Forca e Sigurisë së Kosovës(FSK) -Gjilan, Përfaqësues të KFOR-it Turk për Rajonin Lindje, KFORI Amerikan, Gizi Gjerman ,Agjencia per Emergjenca (AME) ,Shoqata Elita-Gjilan dhe OJQ të ndryshme.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Gjatë periudhës raportuese **Janar-Qershor 2026** janë realizuar një sërë aktivitesh konkrete, si në aspektin operacional ashtu edhe në atë parandalues.

Takim me Stafin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpetim

Janë mbajtur takime të rregullta javore me stafin e drejtorisë me qëllim koordinimin e aktiviteteve dhe rritjen e efikasitetit në punë.



Takim me Inspektorët për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore

Është organizuar takim i veçantë me inspektorët për mbrojtje nga zjarri, ku janë diskutuar masat parandaluese dhe përforcimi i kontrolleve në terren.



Janë realizuar vizita të vazhdueshme në terren për identifikimin e pikave kritike që paraqesin rrezik nga vërshimet dhe ndotja, me fokus të veçantë në pastrimin e lumenjve.

Zyrtarët e drejtorisë kanë hartuar plane konkrete për ndërhyrje emergjente në rast të fatkeqësive natyrore sizjarret, përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut.

Është rritur bashkëpunimi me njësitë e zjarrfikësve për reagim të shpejtë dhe efikas në rastet emergjente.

Janë zhvilluar aktivitete vetëdijësuese për qytetarët lidhur me parandalimin e zjarreve dhe mënyrat e reagimit në raste emergjente.

Janë evidentuar dhe raportuar rastet e ndërhyrjeve emergjente gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë ndërhyrje në zjarre dhe situata të tjera të rrezikshme.

Është bërë monitorimi i vazhdueshëm i zonave me rrezik të shtuar dhe janë ndërmarrë masa parandaluese në kohë.

Janë përgatitur raporte të brendshme për analizën e situatave emergjente dhe përmirësimin e reagimit Institucional.

Drejtoria ka qenë në gatishmëri të plotë operative gjatë gjithë periudhës raportuese.

Inspektimet dhe Parandalimi

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2026, aktiviteti inspektues i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është zhvilluar në mënyrë intensive dhe të organizuar, me fokus të veçantë në rritjen e nivelit të sigurisë dhe parandalimin e rreziqeve në territorin e Komunës së Gjilanit.

Inspektimet janë realizuar në kategori të ndryshme objektesh, duke përfshirë institucione publike, biznese, objekte afariste dhe institucione arsimore, me qëllim të identifikimit të mangësive që mund të paraqesin rrezik për jetën dhe pronën e qytetarëve.

Gjatë këtyre kontrolleve, vëmendje e veçantë i është kushtuar gjendjes së pajisjeve kundër zjarrit,

funksionalitetit të sistemeve të alarmimit, si dhe kushteve të përgjithshme të sigurisë brenda objekteve.

Një aspekt i rëndësishëm i procesit inspektues ka qenë edhe verifikimi i përmbushjes së detyrimeve ligjore nga subjektet e kontrolluara, duke përfshirë posedimin e pajisjeve të nevojshme, mirëmbajtjen e tyre, si dhe zbatimin e procedurave për reagim në raste emergjente.

Në këtë drejtim, inspektorët kanë ofruar udhëzime profesionale dhe këshilla konkrete për përmirësimin e standardeve të sigurisë.

Në rastet kur janë evidentuar parregullsi, janë ndërmarrë masa në përputhje me kompetencat ligjore, duke filluar nga rekomandimet dhe paralajmërimet, deri tek masa të tjera administrative, me qëllim eliminimin e rreziqeve në kohë sa më të shkurtër.

Takim me Kforin Turk dhe Kforin Amerikan



Foto nga vizita e Kforit Turk dhe Kforit Amerikan

Takim me Kforin Turk dhe Kforin Amerikan

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani ka pritur në një takim të veçantë përfaqësues të KFOR-it Turk dhe KFOR-it Amerikan, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e menaxhimit të emergjencave.

Gjatë këtij takimi u diskutua gjerësisht për rolin dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, sfidat me të cilat përballlet kjo drejtori, si dhe për situatat emergjente që kanë ndodhur.

Një fokus i veçantë iu kushtua rasteve të vërshimeve, zjarreve, si dhe emergjencave të tjera natyrore dhe aksidentale që kërkojnë reagim të shpejtë dhe të koordinuar institucional.

Drejtori prezantoi kapacitetet aktuale të Drejtorisë, përfshirë burimet njerëzore dhe logjistike, si dhe nevojat për avancim të mëtejshëm në pajisje dhe trajnime profesionale.

Po ashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë si KFOR-i, në rritjen e gatishmërisë dhe efikasitetit në menaxhimin e situatave emergjente.

Përfaqësuesit e KFOR-it Turk dhe KFOR-it Amerikan shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar mbështetjen dhe bashkëpunimin me institucionet lokale, duke ofruar asistencë në trajnime, shkëmbim përvojash dhe përkrahje në raste emergjente.

Në përfundim të takimit, Drejtori i Drejtorisë z.Enver Shabani falënderoi KFOR-in Turk dhe KFOR-in Amerikan për takimin dhe për mbështetjen e vazhdueshme në funksion të rritjes së sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve dhe u dakorduan që bashkëpunimi ndërinstitucional të thellohet edhe më tej, me qëllim të rritjes së sigurisë për qytetarët dhe reagimit sa më efikas ndaj çdo situatë emergjente.

Vizitat në teren me stafin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për vlerësimin e gjendjes së lumenjve dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje në pastrimin e tyre.



Foto nga vizita e gjendjes së lumenjve



Foto nga vizita e gjendjes së lumenjve

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani, së bashku me Zyrtarët e Drejtorisë për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyore , kanë filluar vizitat në teren në kuadër të aktiviteteve të planifikuara për vlerësimin e gjendjes së lumenjve dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje në pastrimin e tyre.

Gjatë këtyre vizitave në terren, po bëhet inspektimi i detajuar i segmenteve të ndryshme të lumenjve në territorin e komunës, me fokus të veçantë në zonat ku janë evidentuar probleme të mëhershme si grumbullimi i mbeturinave, bllokimi i rrjedhës së ujit, dëmtimi i brigjeve, si dhe rreziku potencial për përmbytje.

Zyrtarët kanë evidentuar të gjitha pikat kritike dhe po mbledhin të dhëna konkrete, të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e një plani të qartë dhe efikas për ndërhyrje.

Ky aktivitet ka për qëllim jo vetëm përmirësimin e gjendjes aktuale të lumenjve, por edhe parandalimin e rreziqeve që mund të paraqiten si pasojë e reshjeve të mëdha apo faktorëve të tjerë natyrorë.

Përmes këtyre vizitave, synohet të rritet niveli i gatishmërisë institucionale dhe të sigurohet një reagim i shpejtë dhe i koordinuar në rast nevojë.

Takim me Komandantin e Stacionit Policor-Gjilan



Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani, është pritur në një takim nga Komandanti i Stacionit Policor në Gjilan, z.Besim Rexhepi, ku u diskutuan çështje me interes të përbashkët në fushën e sigurisë dhe menaxhimit të emergjencave.

Në këtë takim morën pjesë edhe z. Salih Mustafa, përgjegjës i operativës 112 në Gjilan, si dhe z. Hazir Mustafa-Zyrtar për sistemimin e forcave për MSHN në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Gjatë takimit u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit të vazhdueshëm, me qëllim të reagimit sa më të shpejtë dhe efikas në situata emergjente, si dhe rritjen e nivelit të sigurisë për qytetarët.

Po ashtu, u diskutuan mundësitë për avancimin e kapaciteteve profesionale, përmirësimin e sistemeve të komunikimit dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e emergjencave. Palët u dakorduan që bashkëpunimi të vazhdojë dhe të forcohet edhe më tej në të ardhmen.

Ky takim dëshmon përkushtimin e institucioneve përkatëse për të qenë në shërbim të qytetarëve dhe për të garantuar siguri dhe reagim të koordinuar në çdo situatë.

Takim me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë-Gjilan



Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Enver Shabani, ka mbajtur takim me **Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjilan, z. Agron Rukiqi,** në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërinstitucional për rritjen e sigurisë dhe menaxhimin sa më efikas të situatave emergjente.

Në këtë takim morën pjesë edhe z. Salih Mustafa, përgjegjës i operativës 112 në Gjilan, si dhe z. Hazir Mustafa, zyrtar për sistemimin e forcave për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore (MSHN) në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Gjatë takimit u diskutuan në detaje çështje që lidhen me koordinimin ndërinstitucional në raste emergjente, funksionalizimin sa më efikas të sistemit të reagimit të shpejtë, si dhe rolin e secilit institucion në menaxhimin e situatave të krizave.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit në kuadër të operativës 112, shkëmbimit të informacioneve në kohë reale dhe organizimit të përbashkët të ushtrimeve praktike për reagim në raste të zjarreve, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera.

Po ashtu, u diskutua për rëndësinë e planifikimit të përbashkët, ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit, si dhe koordinimit në terren për të siguruar reagim sa më të shpejtë dhe efikas në shërbim të qytetarëve.

Në përfundim të takimit, të dyja palët u dakorduan për thellimin e bashkëpunimit dhe ndërmarrjen e hapave konkretë në funksion të forcimit të sigurisë publike dhe menaxhimit më të mirë të situatave emergjente në rajonin e Gjilanit.

Takim me zv.Komandin e FSK-së në Gjilan



Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Enver Shabani, është pritur në takim nga Zv. Komandanti i FSK-së në Gjilan z.Gëzim Osmani, ku u zhvillua një diskutim i rëndësishëm lidhur me koordinimin dhe bashkëpunimin institucional në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe menaxhimit të emergjencave.

Në këtë takim morën pjesë edhe z. Salih Mustafa, përgjegjës i Operativës 112 në Gjilan, si dhe z. Hazir Mustafa, Zyrtar për sistemimin e forcave për MSHN në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Takimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që kanë rol kyç në menaxhimin e situatave emergjente dhe reagimin ndaj fatkeqësive natyrore apo emergjencave të tjera.

Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e koordinimit të strukturave operative në raste emergjente, planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike për reagim sa më efikas në shërbim të qytetarëve.

Po ashtu, u trajtuan edhe çështje që ndërlidhen me gatishmërinë institucionale, komunikimin operacional dhe bashkërendimin ndërmjet mekanizmave lokalë dhe forcave të sigurisë.

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Enver Shabani, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet e sigurisë dhe mekanizmat emergjentë, duke vlerësuar rolin e FSK-së në ofrimin e mbështetjes në situata të ndryshme emergjente dhe në ruajtjen e sigurisë së qytetarëve.

Ai gjithashtu potencoi se vetëm përmes koordinimit dhe bashkëpunimit të ngushtë institucional mund të arrihet një reagim më i shpejtë dhe më profesional në rast nevojë.

Nga ana tjetër, Zv. Komandanti i FSK-së në Gjilan shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit të përvojave, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe fuqizimit të mekanizmave të reagimit emergjent.

Takimi u vlerësua si shumë konstruktiv dhe në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë, me synim rritjen e efikasitetit institucional dhe avancimin e sigurisë dhe mbrojtjes për qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Vizita studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës-IOWA



Foto nga vizita në Komunen e SIOUX CITY-IOWA



Foto me Njesin e Zjarrfiksave në Qytetin e SIOUX CITY-IOWA



Mirënjohje për Komandantin e Zjarrfiksave në Qytetin e SIOUX CITY-IOWA

Vizita studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës-IOWA

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani pjesë e vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në kuadër të vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit, z. Enver Shabani, ishte pjesë e delegacionit zyrtar të Komunës së Gjilanit gjatë qëndrimit në qytetin e Sioux City, në shtetin e Iowa-s.

Delegacioni, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve komunale, shoqërisë civile dhe institucioneve të sigurisë, zhvilluam takime me përfaqësues të departamenteve dhe institucioneve të ndryshme të Sioux City.

Gjatë kësaj vizite, drejtori Enver Shabani mori pjesë në vizita dhe takime të rëndësishme institucionale, ku u shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, menaxhimit të emergjencave dhe sigurisë publike.

Vizita shërbeu si mundësi për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për krijimin e kontakteve të reja profesionale në funksion të avancimit të kapaciteteve të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Ky bashkëpunim kontribuon në thellimin e miqësisë dhe partneritetit ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Sioux City, duke hapur mundësi të reja për shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim afatgjatë në fusha me interes të përbashkët.

Organizimi i fushatës vetëdijësuese për parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Kryqin e Kuq, Njësinë e Zjarrëfiksave në Gjilan.



Foto nga fushata vetëdijësuese parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit (Qendra e Qytetit)



**Foto nga fushata vetëdijesuse parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit
(Parku i Qytetit)**



Foto nga fushata vetëdijesuse parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit
(Shkolla Fillore "Liria" fshati Pogragjë)



Foto nga fushata vetëdijesuse parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit (Shkolla Fillore "Skenderbeu" fshati Përlepnice)



Foto nga fushata vetëdijesuse parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit (Shkolla Fillore “Esat Berisha” fshati Llashticë)



Foto nga fushata vetëdijesuse parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit (Shkolla Fillore "Agim Ramadani" fshati Zhegër)



**Foto nga fushata vetëdijesuse parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit
(Shkolla Fillore “Thimi Mitko” Gjilan**



Komuna Gjilan
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

**Mos ndiz zjarr
që shkakton rrezik
të përgjithshëm**

**Lajmro për rrezikun nga
zjarri**

112 OSE 193

**Ruajeni ambientin dhe pasurinë e Kosovës
duke mos ndezur zjarr dhe duke denoncuar
ata që ndezin!**

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni **356**, sanksionon me burg nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet çdo person që shkakton rrezik të përgjithshëm përmes ndezjes së zjarreve.



Fushata vetëdijësuese për parandalimin e zjarreve në territorin e Komunës së Gjilanit

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjilanit, në bashkëpunim me Stacionin Policor-Gjilan, Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Gjilan dhe Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega Gjilan, ka filluar fushatën vetëdijësuese për parandalimin e zjarreve në qytet, fshatra dhe në institucionet arsimore të komunës.

Kjo fushatë po organizohet me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për rreziqet që vijnë si pasojë e ndezjes së pakontrolluar të zjarreve, veçanërisht gjatë sezonit veror, kur temperaturat e larta dhe kushtet atmosferike favorizojnë përhapjen e shpejtë të tyre.

Zjarret në fusha, pyje, kullota apo pranë zonave të banuara mund të shkaktojnë dëme të mëdha materiale, që rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe të dëmtojnë rëndë mjedisin.

Në kuadër të kësaj fushate, ekipet e përbashkëta kanë zhvilluar sot aktivitete informuese dhe vetëdijësuese në institucijone arsimore ,shkollat fillore dhe të mesme te komunës, ku nxënësit per së afermi janë njoftuar me rreziqet që shkaktohen nga zjarret, masat parandaluese dhe mënyrat e reagimit në raste emergjente.

Gjithashtu, janë shpërndarë materiale informuese dhe janë zhvilluar takime me qytetarë në zona të ndryshme të qytetit dhe fshatrave me qëllim të ngritjes së vetëdijes për parandalimin e zjarreve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani falënderon të gjitha institucionet partnere për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre në këtë nismë të rëndësishme, e cila synon mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pronës publike dhe private, si dhe ruajtjen e mjedisit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim u bëhet thirrje të gjithë qytetarëve që të tregojnë kujdes maksimal, të mos ndezin zjarre në hapësira të hapura, të mos hedhin mbetje që mund të shkaktojnë zjarr dhe të raportojnë menjëherë çdo rast të dyshuar tek institucionet përgjegjëse tek numri 112 ose 193.

Organizimi i punëtorisë me temën “Ushtrim Tavoline – Tërmet-për Komunën e Gjilanit, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent (AME) dhe me mbështetjen e Misioni i OSBE-së në Kosovë



Foto e ekpit pjesëmarrës në puntorinë ushtrim tavoline-Tërmet në Komunën e Gjilanit



Foto e ekpit pjesëmarrës gjatë ushtrimit në tavoline-Tërmet në Komunën e Gjilanit

Organizimi i punëtorisë me temën “Ushtrim Tavoline – Tërmet-për Komunën e Gjilanit

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjilanit, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent (AME) dhe me mbështetjen e Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka organizuar dhe zhvilluar punëtorinë me temën “Ushtrim Tavoline – Tërmet”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve lokale dhe qendrore, shërbimeve emergjente dhe akterëve të tjerë relevantë të përfshirë në menaxhimin e situatave emergjente.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte rritja e nivelit të gatishmërisë dhe testimi i kapaciteteve të institucioneve për reagim në rast të një tërmeti me pasoja në territorin e Komunës së Gjilanit. Përmes një skenari të simuluar, pjesëmarrësit paten mundësinë të analizojnë procedurat e reagimit emergjent, koordinimin ndërinstitutional, menaxhimin e informacionit dhe vendimmarrjen në situata krizash.

Gjatë zhvillimit të ushtrimit, u trajtuan një sërë situatash të mundshme që mund të paraqiten pas një tërmeti, duke përfshirë dëmtimin e infrastrukturës publike dhe private, ndërprerjen e shërbimeve bazike, nevojën për evakuim të popullatës, organizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit, si dhe ofrimin e ndihmës së parë dhe strehimit emergjent për qytetarët e prekur.

Pjesëmarrësit diskutuan mbi mënyrat e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe identifikuan veprimet prioritare që duhet të ndërmerren në orët e para pas ndodhjes së një fatkeqësie të tillë.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve, me qëllim të sigurimit të një reagimi të shpejtë, të koordinuar dhe efektiv. Gjithashtu, u diskutuan sfidat që mund të hasen gjatë menaxhimit të një emergjence të shkallës së gjerë dhe u prezantuan rekomandime konkrete për përmirësimin e planeve operative dhe procedurave të reagimit.

Punëtorja shërbeu si një mundësi e mirë për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, shkëmbimin e përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve në fushën e menaxhimit të emergjencave.

Përmes këtij ushtrimi u vlerësua niveli aktual i përgatitjes së institucioneve dhe u identifikuan fushat ku nevojiten përmirësime të mëtejshme për të siguruar një reagim sa më efikas ndaj fatkeqësive natyrore.

Në përfundim, pjesëmarrësit vlerësuan se ushtrime të tilla janë të domosdoshme për rritjen e gatishmërisë institucionale dhe për forcimin e mekanizmave të koordinimit, duke kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pronës dhe mjedisit në rast të ndonjë tërmeti apo fatkeqësie tjetër natyrore në Komunën e Gjilanit

Puntoria e mbajtur me temën “Transformimi Digjital dhe Zgjidhjet e Mençura Komunale” organizuar nga Cactus Education.



Foto e ekpit pjesëmarrës gjatë punëtorisë “Transformimi Digjital dhe Zgjidhjet e Mençura Komunale” (Komuna e Gjilanit)



Foto e ekpit pjesëmarrës gjatë punëtorisë “Transformimi Digjital dhe Zgjidhjet e Mençura Komunale” (Komuna e Gjilanit)

Puntoria e mbajtur me temën “Transformimi Digjital dhe Zgjidhjet e Mençura Komunale” organizuar nga Cactus Education

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim mori pjesë në punëtorinë me temë “**Transformimi Digjital dhe Zgjidhjet e Mençura Komunale**”, e organizuar nga Cactus Education.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte prezantimi i praktikave moderne dhe zgjidhjeve inovative që ndihmojnë komunat në procesin e transformimit digjital, rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike dhe përmirësimin e qeverisjes lokale.

Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit u njoftuan me trendet më të fundit në fushën e digjitalizimit, përdorimin e teknologjive të avancuara për menaxhimin e proceseve komunale, si dhe me mundësitë që ofrojnë platformat digjitale për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në kuadër të prezantimeve dhe diskutimeve u trajtuan tema që lidhen me qytetet e mençura (Smart Cities), përdorimin e të dhënave për vendimmarrje më efektive, sigurinë e informacionit, si dhe integrimin e teknologjive inovative në administratën publike.

Përfaqësuesit e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim morën pjesë aktive në diskutime, duke paraqitur sfidat dhe nevojat që hasen në menaxhimin e emergjencave dhe mbrojtjen civile.

Në veçanti, u diskutua mbi rëndësinë e përdorimit të sistemeve digjitale për monitorimin e rrezeve natyrore, koordinimin ndërinstitutional gjatë situatave emergjente, menaxhimin e informacioneve në kohë reale dhe komunikimin më efikas me qytetarët.

Punësoria ofroi gjithashtu mundësi për shkëmbim përvojash me përfaqësues të institucioneve të tjera komunale dhe organizatave partnere, duke kontribuar në identifikimin e praktikave të mira dhe mundësive për bashkëpunim në të ardhmen.

Përmes prezantimeve dhe sesioneve interaktive, pjesëmarrësit fituan njohuri të reja mbi zgjidhjet teknologjike që mund të aplikohen në institucionet publike për të rritur transparencën, efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve.

Pjesëmarrja e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në këtë punëtori paraqet një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe në mbështetjen e proceseve të modernizimit institucional. Njohuritë dhe përvojat e fituara gjatë këtij aktiviteti do të shërbejnë për identifikimin e mundësive konkrete për aplikimin e zgjidhjeve digjitale në funksion të rritjes së sigurisë së qytetarëve, përmirësimit të menaxhimit të emergjencave dhe avancimit të shërbimeve që ofron drejtoria

Puntoria e mbajtur me temën “Përmirësimi i të kuptuarit të rrezikut nga fatkeqësitë, parashikimi i bazuar në ndikim dhe paralajmërimi i hershëm”, e organizuar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në bashkëpunim me Bankën Botërore



Foto e ekpit pjesëmarrës gjatë punëtorisë “Përmirësimi i të kuptuarit të rrezikut nga fatkeqësitë, parashikimi i bazuar në ndikim dhe paralajmërimi i hershëm ”



Foto e ekpit pjesëmarrës gjatë punëtorisë “Përmirësimi i të kuptuarit të rrezikut nga fatkeqësitë, parashikimi i bazuar në ndikim dhe paralajmërimi i hershëm ”

Puntoria e mbajtur me temën “Përmirësimi i të kuptuarit të rrezikut nga fatkeqësitë, parashikimi i bazuar në ndikim dhe paralajmërimi i hershëm”, e organizuar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në bashkëpunim me Bankën Botërore

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani mori pjesë në punëtorinë “Përmirësimi i të kuptuarit të rrezikut nga fatkeqësitë, parashikimi i bazuar në ndikim dhe paralajmërimi i hershëm”, e organizuar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në bashkëpunim me Bankën Botërore, në kuadër të projektit për Parandalimin dhe Përgatitjen ndaj Fatkeqësive (TAFF).

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte ngritja e kapaciteteve institucionale për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, si dhe përmirësimi i mekanizmave të paralajmërimit të hershëm dhe reagimit ndaj emergjencave.

Gjatë puntorisë u diskutua mbi rëndësinë e analizimit të rreziqeve, përdorimin e të dhënave meteorologjike dhe hidrologjike për parashikimin e ngjarjeve të mundshme, si dhe zhvillimin e sistemeve efektive të paralajmërimit që mundësojnë reagim më të shpejtë dhe më të koordinuar nga institucionet përgjegjëse.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua konceptit të parashikimit të bazuar në ndikim, i cili fokusohet jo vetëm në parashikimin e fenomenit natyror, por edhe në vlerësimin e pasojave që ai mund të ketë ndaj popullatës, infrastrukturës, ekonomisë dhe mjedisit.

Në këtë kuadër, pjesëmarrësit u njohën me praktika dhe modele të avancuara për vlerësimin e rrezikut dhe planifikimin e masave parandaluese.

Punëtorja shërbeu gjithashtu si platformë për shkëmbimin e përvojave ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale, duke nxitur bashkëpunimin dhe koordinimin në fushën e menaxhimit të emergjencave.

Përfaqësuesit e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim kontribuan në diskutime duke ndarë përvojat dhe sfidat me të cilat përballen institucionet lokale në menaxhimin e situatave emergjente, veçanërisht në rastet e vërshimeve, zjarreve dhe fatkeqësive të tjera natyrore.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet paraqet një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve profesionale të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, përmirësimit të planifikimit dhe koordinimit ndërinstitucional, si dhe rritjes së gatishmërisë për mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit në rast të fatkeqësive dhe emergjencave të ndryshme.

Takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike



Foto gjatë takimit me Drejtorin e Shërbimeve Publike

Takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani ka zhvilluar një takim pune me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z.Kushtrim Ibrahim, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e çështjeve që lidhen me sigurinë publike, mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për ndërhyrje emergjente.

Gjatë takimit është diskutuar në detaje për gjendjen aktuale të lumenjve, përrenjve dhe kanaleve kulluese në disa zona të Komunës së Gjilanit, ku është vlerësuar e nevojshme ndërmarrja e veprimeve konkrete për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

U theksua se grumbullimi i mbeturinave, dhe materialeve të tjera në shtretërit e lumenjve paraqet rrezik potencial për bllokimin e rrjedhës së ujit dhe shkaktimin e vërshimeve gjatë periudhave me reshje intensive.

Një temë e rëndësishme e diskutimit ishte edhe gjendja e disa rrugëve dhe korridoreve të qasjes në zonat rurale dhe kodrinore, të cilat aktualisht janë të vështira ose të pamundura për t'u kaluar nga automjetet e Njesisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. Po ashtu u vlerësua se hapja, zgjerimi dhe mirëmbajtja e këtyre rrugëve është e domosdoshme për të mundësuar reagim të shpejtë dhe efikas në raste zjarresh, aksidentesh, fatkeqësish natyrore dhe emergjencash të tjera që mund të rrezikojnë jetën dhe pronën e qytetarëve.

Gjatë takimit është diskutuar për identifikimin e lokacioneve prioritare ku nevojitet ndërhyrje urgjente, duke marrë parasysh kërkesat e banorëve dhe vlerësimet e ekipeve profesionale në terren.

Të dy drejtorët u pajtuan se përmirësimi i qasjes në këto zona do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së qytetarëve, lehtësimin e lëvizjes së banorëve dhe krijimin e kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve emergjente.

Në fund të takimit, u dakordua që drejtoritë përkatëse të intensifikojnë bashkëpunimin dhe koordinimin institucional, me qëllim planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve në terren për pastrimin e lumenjve dhe hapjen e rrugëve prioritare, duke kontribuar në rritjen e gatishmërisë dhe sigurisë së përgjithshme në Komunën e Gjilanit.

Takim me Shefin e Agjensisë së Pyjeve-Gjilan



Foto gjatë takimit me Shefin e Agjensisë së Pyjeve-Gjilan

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Enver Shabani ka zhvilluar një takim pune me z. Kujtim ShahiqiShef në Agjensinë e Pyjeve-Gjilan, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje gjatë sezonit me temperatura të larta.

Gjatë takimit është diskutuar për gjendjen aktuale në zonat pyjore të Komunës së Gjilanit, nivelin e rrezikut nga zjarret, si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në rastet e intervenimeve emergjente. Vëmendje e veçantë iu kushtua identifikimit të zonave më të ekspozuara ndaj zjarreve dhe nevojës për rritjen e masave parandaluese me qëllim të mbrojtjes së pyjeve dhe mjedisit.

Po ashtu, pjesë e diskutimeve ishte edhe gjendja e rrugëve malore dhe pyjore, ku u evidentuan disa segmente që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mirëmbajtje.

Të dyja palët u pajtuan për nevojën e vazhdimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve në terren, me qëllim të rritjes së gatishmërisë institucionale, mbrojtjes së pasurisë pyjore dhe minimizimit të rrezikut nga zjarret.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e ndërmarrjes së veprimeve konkrete për identifikimin dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat malore, e cila paraqet një element të rëndësishëm për reagim efikas dhe menaxhim të suksesshëm të emergjencave në pyjeve.




Foto gjatë puntorisë me Gizin Gjerman

Puntoria e mbajtur me Gizin Gjerman

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka organizuar një punëtori në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman, me temën "**Plani Operativ Emergjent Lokal**".

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte forcimi i kapaciteteve institucionale në planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e situatave emergjente në nivel lokal.

Gjatë punimeve u trajtuan aspektet kryesore të hartimit dhe përditësimit të Planit Operativ Emergjent Lokal, duke u fokusuar në identifikimin e rreziqeve, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve përkatëse, si dhe koordinimin ndërinstitutional në rast të fatkeqësive natyrore apo emergjencave të tjera.

Pjesëmarrësit diskutuan praktikat më të mira për reagim të shpejtë dhe efektiv, shkëmbyen përvoja profesionale dhe kontribuan me rekomandime konkrete për përmirësimin e planit, me synim rritjen e gatishmërisë dhe sigurisë së qytetarëve.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim shpreh mirënjohje për mbështetjen dhe bashkëpunimin e GIZ-it Gjerman në organizimin e kësaj punëtorie, e cila përbën një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të sistemit lokal të menaxhimit të emergjencave.

Raporti i Njesisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit-Gjilan Janar-Qershor 2026.

Gjatë periudhës Janar–Qershor 2026, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Gjilan ka realizuar gjithsej 259 intervenime në terren, duke dëshmuar gatishmëri të lartë operative dhe përkushtim maksimal në shërbim të qytetarëve. Këto intervenime përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh, duke filluar nga shuarja e zjarreve të ndryshme (në objekte banimi, lokale afariste, hapësira të hapura dhe fusha), ndërhyrje në aksidente trafiku, si dhe operacione të shpëtimit dhe asistencës në raste emergjente.



REPUBLIKA E KOSOVËS

Ministria e Punëve të Brendshme

Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave / Komuna e Gjilanit

Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

Stacioni i Zjarrfikjes Rr.: __ isa boletini

Tel.zyrtar: __ 0280/310-990

„ 193 " & 0280 / 320-503

emaili: murat.ramadani@rks-gov.net

bzsh-gjilan@hotmail.com



Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, zjarreve dhe intervenimeve tjera Janar - Dhjetor 2026 Komuna Gjilanit

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera Janar-Dhjetor 2025														
2026	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar zj.	qyt.	tot	Të vdekur zj.	qyt.	tot	Githsejt
Janar	45	27	9	1	1	7	0	0	0	0	0	0	0	45
Shkurt	16	13	0	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0	16
Mars	54	49	2	0	1	0	2	0	3	3	0	0	0	54
Prill	49	34	5	4	2	0	4	0	2	2	0	0	0	49
Maj	49	32	13	2	2	0	0	0	2	2	0	0	0	49
Qershor	46	34	5	6	1	0	0	0	1	1	0	1	1	46
Korrik										0			0	0
Gusht										0			0	0
Shtator										0			0	0
Tetor										0			0	0
Nëntor										0			0	0
Dhjetor										0			0	0
Gjithsejtë	259	189	34	15	7	7	7	0	8	8	0	1	1	259

Raporti i shpenzimeve Janar-Qershor 2026

Realizimi i shpenzimeve financiare me përqindje për periudhën gjashtë mujore **2026** është **43.36 %** sipas planifikimit të shpenzimeve

Shpenzimet e mjeteve për Paga, Mallra e Shërbime, Komunal dhe Investime Kpitale; nga fondi burimor 10 , 21 , sipas kodeve ekonomike

Nr. rend	Përshkrimi	Stafi		Paga dhe meditje	Mallra dhe Shërbime		Shpenz. Komunale		Subvecione dhe Transfe	Shpenz. Kapitale	Totali
		42		11000	13000		13200				
	Fondi Burimor			10	10	21	10	21	**	**	
	Mjetet e Planifikuara			405,554.00	190,000.00	25,000.00	7,000.00	1,000.00	60,000.00		688,554.00
	Mjetet e Alokume	42	TM-I								0.00
TM-2				**	**					0.00	
TM-3				**	**					0.00	
TM-4				**	**					0.00	
	Gjithsej të Shpenzuara			(213,543.34)	(80,441.97)		(4,600.00)				(298,585.31)
	Mjetet e Zotume			**	(10,847.60)						(10,847.60)
	Mjetet e mbetura			192,010.66	98,710.43	25,000.00	2,400.00	1,000.00	60,000.00	-	379,121.09
Mjetet që nevojiten deri fund vitit pa ndryshime për paga											
Mos plotsimi i vendeve të punës, Mjete në suficit											

Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet relevante si Policia e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës(FSK)- Gjilan ,njësitë e zjarrfikësve, strukturat komunale,Shoqatën ELITA, organizatat tjera.

Janë zhvilluar takime koordinuese me qëllim përmirësimin e reagimit në raste emergjente dhe shkëmbimin e informacioneve në kohë reale.

Donacionet :

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar një donacion shumë të rëndësishëm nga Kantonit i Cyrihut, i cili ka dhuruar një automjet modern zjarrfikës për Njësine Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.

Donacioni i automjetit zjarrfikës, së bashku me pajisjet përcjellëse, për Njësine Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Gjilan, përbën një mbështetje jashtëzakonisht të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve tona në mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve tanë.

Ky donacion përfaqëson një mbështetje të çmuar për rritjen e kapaciteteve operationale në menaxhimin e emergjencave dhe forcimin e sigurisë për qytetarët tanë.



Pranimi I donacionit nga Zyrtarët e Kantonit të Cyrihut :

- z. Mario Fehr, anëtar i Qeverisë së Kantonit të Cyrihut,
- z. Daniel Wäfler, anëtar i Këshillit Kantonal,
- z. Renato Mathys, Shef i shërbimit të Zjarrfikjes



Pranim i donacionit nga Kryetari i Komunës z.Alban Hyseni

Sfidat

Gjatë realizimit të aktiviteteve janë hasur disa sfida, si:

- Mungesa e pajisjeve moderne për ndërhyrje në disa raste specifike.
- Nevoja për trajnime të avancuara për stafin profesional.
- Vetëdijesimi i pamjaftueshëm i qytetarëve për parandalimin e rreziqeve.
- Kufizimet buxhetore për investime kapitale.

Planet për Gjashtëmujorin e Ardhshëm

Për periudhën në vazhdim janë planifikuar këto aktivitete:

- Vazhdimi i inspektimeve sistematike në terren.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese për qytetarët dhe bizneset.
- Thellimi i bashkëpunimit ndërinstitutional.
- Investime në pajisje dhe ngritje të kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve.
- Hartimi i planeve të reja për menaxhimin e emergjencave.

Enver Shabani

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim